

Data 22.12.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Sistemim Asfaltim rruga Gryka Vloçisht –Drithas poshtë faza 2 viti 2022”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45233120-6

VLERA E FONDIT LIMIT:

12.621.493 (dymbëdhjetë milion e gjshtëqind e njëzet e një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tre)lekë pa Tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Maliq**_ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

c. *Deklarate nga Operatori Ekonomik qe punonjesit dhe mjetet e deklaruarra ne formularin e vetdeklarimit per kete procedure nuk jane te angazhuar ne kontrata te tjera.(Mosplotesimi i ketij kriteri perben kusht per skualifikim).*

d.*Deklarate nga operatori ekonomik ku te pasqyroje te dhenat ne lidhje me kontratat e lidhura ose ne proces me autoritete te tjera kontraktore si me poshte :*

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Deklarata per mjetet dhe punonjesit eshte e nevojshme per arsye se punimet duhet te realizohen ne cilesine dhe afatin e kerkuar sipas dst.

Deklarata per kontratat e lidhura apo ne proces eshte e nevojshme pasi ne kete menyre autoritetit kontraktor mund te verifikoje nese punonjesit dhe makinerite jane te angazhuara dhe ne kontrata te tjera.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Per kapacitetin ligjor /profesional te operatoreve ekonomike:

Sipas kriterëve të përgjithshme të Pranim / Kualifikimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2019,2020,2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilancit per vitet 2019, 2020.2021 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

Kriteret e kërkuara në pikën 2.2.1 dhe 2.2.2. janë vendosur me qëllim që të vërtëtohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet e nevojshme financiare për përmbushjen e kontratës.

2.2.3 Vërtetimi për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetet për vitin 2021 sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.

sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së kontratës që prokurohet ,dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marre së bashku gjatë pesë viteve të fundit të jete jo më të vogël se fondi limit i kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme në sektorin publik, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- Formular vlerësimi
- Situacion përfundimtar të objektit,

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Situacionin përfundimtar të objektit;
- Fatura tatimore
- Vërtetim për kryerjen me sukses të kontrates

(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës: Operatori ekonomik duhet të dorëzojë:

a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

1. NP 1 - A (Punime germimi në tokë)
2. NP 4 - A (Rruge, autostrada, mbikalime etj)
3. NP 7 - A (Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi dhe vaditje)

**Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë liçencat profesionale sipas zerave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr persiper të realizojë).

(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimit Nr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, “për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” (shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategori a e kërkuar	Pershkrimi I kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikasi mit i kërkuar për kategori në respektiv e	Vlera e punimeve (pa tvsh) që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP 1	<i>Punime germimi ne toke</i>	1.Punime germim dheu	A	
NP 4	<i>Rruge ,autostrada,mbikalime etj</i>	1.punime ne rruge	A	
NP 7	Ujesjellesa,gazsjellesa,vajsjellesa,vepra kullimi dhe vaditje	1.Punime KUB	A	

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një **Deklarate (nga Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë te perfshirë në licensën e shoqërisë. Drejtuesi teknik duhet te jete :

Inxhinier Ndertimi

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë

2.3.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier gjeodet (1)
- Inxhinier elektrik (1)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë

Argumentimi: Për kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3. dhe 2.3.4 Njësia e Prokurimit është bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, “Për Prokurimin Publik” datë 23.12.2020, pika 4 si dhe në VKM nr 285 datë 19.05.2021 “për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” neni 39 pika 6 c. Duke marrë parasysh natyrën e punimeve është kërkuar që drejtuesi teknik të jetë inxhinier ndërtimi. Përsa I përket stafit mbështetës janë kërkuar :

Inxhinier gjeodet në lidhje me punimet për kuatat e rugeve dhe Inxhinier elektrik në lidhje me punimet elektrike që do kryhen..

2.3.5 Shoqëria duhet të paraqesë Çertifikata ISO të vlefshme:

1. ISO 9001- 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë).
2. ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit).
3. ISO 45001-2018 (Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)
4. PASS 99:2012 (Sistemi i integruar i menaxhimit).

Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH ose standardeve shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikata ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Për kriteret e përcaktuara në Kapacitetin teknik, Njësia e prokurimit ka zbatuar VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 44 “Kërkesat e cilësisë”, si dhe bazuar në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr.8197 prot. datë 03.09.2018 ,për “Hartimin e Kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra,punë,shërbime. Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të jetë i certifikuar me çertifikatat Iso

2.3.6 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 9 punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- **Murator (2)**

Bazuar në zerrat e punimeve sipas preventivit Punime murature ,mur guri,FV bordure,kërkohet që operarori ekonomik të disponojë 2 muratore të cilët do të realizojne këto punime.

- **Hidraulik (1)**

Bazuar në zerrat e punimeve sipas preventivit punime KUB nw rruge , ,kërkohet që operarori ekonomik të disponojë 1hidraulik qe do të realizojne këto punime.

- **Manovrator (2)**

Bazuar në zerrat e punimeve sipas preventivit Germim dheu me eskavator ,mbushje rrafshim ,ngjeshje dheu, si dhe hedhje shtrese asfaltbetoni,jane kerkuar mjetet eskavator,grejder,rul dhe asfaltoshtruese.Per drejtimin e mjeteve te renda eshte kerkuar qw operatori ekonomik të disponojë 2 manovrator .

- **Elektracist (2)**

Bazuar në zerrat e punimeve sipas preventivit punime elektrike ,jane kerkuar jane kerkuar2 elektracist per keto punime.

- **Pllakashtrues (2)**

Bazuar në zerrat e punimeve sipas preventivit nevojiten 2 pllakashtrues per kryerjen e punimeve veshje me pllaka .

Argumentimi:Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Përprokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorë ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 15 persona**, per 2 muaj. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kriteret e percaktuara ne piken 2.3.7.Eshtë kerkuar që operatori ekonomik të ketë një staf prej 4 punonjësit për të realizuar punimet ,nga zberthimi i preventivit të punimeve me manualin e miratuar me Vendimin Nr.629, datë 15.07.2015 ”Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre ” .

<u>zberthimi</u>						

OBJEKTI: SISTEMIM ASFALTIM RRUGA GRYKA VLOCISHT -DRITHAS POSHTE
Faza II (2022)

Nr	Nr. AN	PËRSHKRIMI I PUNIMEVE	Njësi	Sasi	OP/N	OP/GJ
			a	a	J	
I		PUNIME NE RRUGE				
1	2.26	Gërmim dhe me eskavator, goma 0.25m ³ , në kanale me gjerësi > 2m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet	m ³	410	0.062	25
2	2.1	Germi dheu me krah e transport me karoce dore kat III	m ³	50	3.7	185
3	3.158/1a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 1.0 km	m ³	460	1	460
4	3.207	Shtrese cakulli makadam t = 10cm	m ²	150	0.045	7
5	3.212/b	Shtresë stabilizanti t=10cm	m ²	210	0.075	158
6	3.222/1	Shtrese binderi t = 5cm	m ²	255	0.109	278
7	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t = 4cm	m ²	255	0.095	242
8	3.617/1	F.V. Bordura rruge e parafabrikuar 15x30 cm	ml	600	1	600
9	3.616	F.V. Bordura trotuari e parafabrikuar 12x25 cm	ml	405	0.6	243
10	3.205	Shtrese zhavori t=10cm	m ²	415	0.026	11
11	An	Shtrese me pllaka veteshternguese t = 6cm	m ²	496	2.14	1,061
12	3.324	Mur guri mozaik me llaç të përzier M 25	m ³	30	12.7	381
13	3.639	Veshje me pllaka guri 50x40, 50x50 cm (mbi mur)	m ²	50	1.15	58
14	3.205	Shtrese zhavori t = 10cm (shkallet)	m ²	200	0.026	5
15	2.262/4	Shtrese betoni C 16/20 (shkallet)	m ³	25	8.6	215
16	3.639	Veshje me pllaka guri 50x40, 50x50 cm (shkallet)	m ²	225	1.15	259
17	An 163	FV Fidane e lule dekorative	cop	50	2	100
		SHUMA I				0
II		PUNIME K.U.B NE RRUGE				0
1	2.25/a	Gërmim dheu me eskavator goma 0.25m ³ , në knale me gjerësi deri në 2m, tokë zakkategoria III, me shk. në toke	m ³	100	0.067	7
2	An	F.V. Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 Dn=200mm	ml	250	0.6	150
3	An	Shtresë material I bute rreth tubos t=20cm	m ³	25	0.88	22

4	3.47/1a	Mbushje ,rrafshim ngjeshje dheu me tokmak elektrik cdo 30 cm toke e zakonshme	m ³	45	1.25	56
5	3.158/1a	Transport materiale ndërtimi,dheu me auto deri 1.0 km	m ³	20	1	20
6	An-22/1	Ndërtim puseta 40x40, h=100cm me zgare gize per ujrart e shiut	cop	5	4.2	21
7	An-23	Ndërtim puseta 40x60, h=100cm me zgare gize per ujrart e shiut	cop	4	5.6	22
8	An	Ngjitje pusetash KUZ	cop	5	4.2	21
9	2.554	F.V Tubo betoni Ø 400 mm	ml	12	2.1	25
		SHUMA II				0
III		PUNIME ELEKTRIKE				0
1	3.25/b	Germim me krah seksion I detyruar	m ³	42	3.6	151
2	2.114/1	Beton C 16/20	m ³	12	12.8	154
3	An/53	F.Vshtylla metalike per ndricim komplet h=8 ml	cop	15	1.8	27
4	An	F.V Ndricesa me llamb led 32 W	cop	15	1.5	23
5	3.An/pp	F.V puseta elektrike pvc 40*40	cop	15	2	30
6	3.An/el	F.V elektroda togezime	cop	15	0.3	5
7	4.142/1.2 9	F.V kabell te vendosur ne toke 4*4 mm2	ml	750	0.1	75
8	2.482/1	F.V kabell 3*1.5 mm2	ml	150	0.1	15
9	3.654/1	F.V. tub brinjezuar plastik Ø 90	ml	750	0.1	75
	2.a-109	F.V. Panel komandimi ndricimit rrugor	cope	1	8	8
						5,194

- Nga zberthimi i preventivit oret e punes per cdo ze punimi rezultojne 5194.
- Oret në total i pjestojmë me 8 orë pune ditore 5194 : 8 = 650 kemi 1241 punëtorë për një ditë pune
- 650 punëtorë për një ditë punë pjestuar më 22 ditë pune mujore kemi 30 punëtorë për një muaj punë.
- 30 punetore shpërndarë sipas grafikut, rezulton 15 punëtorë për 2 muaj.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te kete ne pronesi ose me qira mjetet e domosdoshme per realizimin e kontrates si me poshte :

Mjetet	Sasia	Gjendja
1. Eskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
2. grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
3. Rul me vibrim	1 copë	Pronësi ose me qera
4. Autobitumatrice	1 cope	Pronësi ose me qera

5. Kamion vetshkarkues nga 7-15 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
6. Kamioncine deri 3.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
7. Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
8. Betoniere	1 cope	Pronësi ose me qera
9. Autobot	1 cope	Pronësi ose me qera

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Police sigurimi (e vlefshme)
4. Mjeti të shoqerohet me fotografi të dukshme
5. Certificate per leje transporti të leshuar nga Bashkia

dhe për mjetet me qera,

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
4. Police sigurimi (e vlefshme)
5. Mjeti të shoqerohet me fotografi të dukshme.]
6. Certificate per leje transporti të leshuar nga Bashkia

Ne rastin e mjeteve me qera sipas njoftimit të APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit ,mjetet nuk duhet të rezultojnë vetëm për përdorim vetjak por edhe për përdorim nga të tretet.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre duke paraqitur aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

1- Betoniere 1 copë

Bazuar në zërin e preventivit për punime betoni është kërkuar 1 betoniere.

2- Kamion vetshkarkues 2 cope

Bazuar në zërin e preventivit transport dheu,transport material ndertimi , kerkohen 2 kamion vetshkarkues .

3- Kamioncinë 1 cope

Është kërkuar 1 kamioncine për transportin e materialeve të ndryshme dhe të punonjësve

4- Autobitumatrice 1 cope

Është kërkuar 1 autobitumatrice per sperkatjen me bitum.

5- Eskavator (1)

Është kërkuar 1 eskavator per zerrat e punimeve Germim dheu me shkarkim ne mjet.

6- Grejder (1)

Bazuar në zërat e preventivit të punimeve “Shtresë stabilizanti” kërkohet që operatori ekonomik të disponojë 1 mjet Grejder per shpërndarje dhe nivelim.

7- Rul me vibrim (1)

Bazuar në zërin e preventivit për punime në rrugë dhe shtresë stabilizanti është kërkuar 1 rul për ngjeshje.

8- Autobot (1)

9- Asfaltoshtruese (1)

Bazuar në zërin e preventivit shtresë asfaltobetoni është kërkuar 1 asfaltoshtruese .

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*